- (d) Nëse ekziston një mospërputhje midis fjalëve dhe shifrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë, përveç nëse shuma e shprehur me fjalë lidhet me një gabim aritmetik, rast në të cilin shuma në shifra do të mbizotërojë në bazë të (a) dhe (b) më sipër.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- vlera absolute e të gjitha korigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- vlera absolute e të gjitha korigjimeve është më pak se 2%, por korigjimi nuk pranohet nga ofertuesi.

2. Kur autoritetet /entet kontraktore vërejnë se oferta është anomalisht e ulët, i kërkojnë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin dhe në përputhje me dispozitat e këtij neni.

- Në rast kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët kur zvogëlohet më shumë se 25% të fondit limit të përlogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më pak se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, para se të marrë një vendim për kualifikimin e tyre ose jo, në përputhje me nenin 93 të LPP-së.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja

e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

- 23. Njoftimi i Fituesit**
1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.
- 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**
1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
 2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.
- Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:
- a) garanci bankare
 - b) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

- 25. Procedura e ankesës**
1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
 2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

- 26. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
 2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
- e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 7. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 8. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të kualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)

Formulari 12- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraprak)

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	6	
Artikulli	Përshkrimi i shërbimit	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Mbetjet e rrezikshme duhet të asgjësohen në një impiant për incenerim i cili është i licencuar nga Ministria e Mjedisit për kryerjen e këtij shërbimi sipas përcaktimeve të mëposhtme në lidhje me to:

Kërkesat e mëposhtme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", nenin 41, pika 4, gërma a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*", si dhe në mbështetje të ligjit Nr. 10431 datë 09.06.2011, "*Per mbrojtjen e mjedisit*", ligjit Nr.9537, datë 18.5.2006 "*Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme*", ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011, "*Per lejet e mjedisit*" i ndryshuar, ligjit nr.9010, datë 13.2.2003 "*Per administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta*", ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 "*Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, "*Per menaxhimin e integruar të mbetjeve*" të ndryshuar , Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.798, datë 29.9.2010 "*Për Miratimin e Rregullores "Për Administrimin e Mbetjeve eSpitalore"*", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 402, dt.30.06.2021 "*Per miratimin e katalogut shqiptar të mbetjeve*"; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 538, datë 26.05.2009, "*Per licensat dhe lejet, që trajtohen nga/apo nepermjet QKB dhe disa rregullime të tjera nenligjore të perbashketa*" e ndryshuar, Udhëzimin Kombëtar "*Per Menaxhimin e Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore*" dhe sipas përcaktimeve të bera në Udhëzuesin Kombëtar "*Administrimi i sigurt i Mbetjeve Spitalore*".

1. Asgjësimi duhet të realizohet me një prej metodave për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore të përcaktuara në VKM nr 798 datë 29.09.2010 ,
2. Mbetjet do të merren nga sipërmarrësi pranë ambjentit të shërbimit që do të vendoset nga SRV, me automjetet e tij të posaçëm/qira, lehtësisht të identifikueshme gjatë transportit të mbetjeve me shenjen dalluese ndërkombëtare të rrezikut të mbetjeve të rrezikshme

spitalore ne perputhje me pikat 8.8/c dhe shtojcen nr.4 te VKM – se Nr.798 dt.29.09.2010 dhe sipas percaktimeve te bera ne udhezuesin kombetar “Administrimi i sigurte i mbetjeve te rrezikshme spitalore”. Terheqja e mbetjeve do te behet sipas nevojave dhe kerkeses se AK –se.

3. Të furnizojë me kontenierë AK sipas standarteve dhe kërkesave të VKM Nr. 798 date 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore” pika 8/4 dhe 8/5 të kreut III, trajtimi i mbetjeve spitalore, si vijon:

- Kontenitor plastike njëpërdorimësh për të mprehtat 18 01 01: përmasa që fillon nga 3L-12L
- Kontenier plastike të ripërdorshëm të mëdhenj me qese plastmasi njëpërdorimësh për anatomiket 18 01 02 dhe infektivet 18 01 03, te cilet per cdo perdorim duhet ti nenshtorhen pastrimit dhe larjes ne makinerine e posacme te operatorit: përmasa që fillojnë nga 40 L deri ne 60 L
- Kontenitor kartoni njëpërdorimësh 18 01 04
- Kontenitor te posacem te kuq përmasa deri ne 20L per citostatiket 18 01 08
- Kuti të kyçura / te posacem per farmaceutiket 18 01 09

4. Mbetjet e gjeneruara nga shërbimet do të peshohen në praninë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik dhe perfaqesuesit te AK - se ku do hartohet proces-verbali për sasinë e peshuar, pa përfshirë kutitë e ambalazhimit (pesha e tyre zbritet). Ambalazhimi (kontenieret, kutite, qeskat, etj.) do të mbulohen nga subjekti fitues.

5. Peshimi i mbetjeve do të kryhet nga një peshore e kolauduar nga Drejtoria e Metrologjisë, që do të vihet në dispozicion nga ana e operatorit ekonomik (OE te sjelle dhe certifikaten e kolaudit te peshores).

6. Pas marrjes në dorëzim të mbetjeve, nga ana e Operatorit Ekonomik do të bëhet dezinfektimi i ambientit nga ku do të tërhiqen mbetjet e rrezikshme spitalore të kontaminuara. Mbetjet e rrezikshme, që dorëzohen nga një person fizik a juridik tek një tjetër, shoqërohen me dokument transferimi, sa herë që do të bëhet evadimi i këtyre mbetjeve.

7. Operatori ekonomik duhet te instaloje nje frigorifer ne ambientet e Drejtorise se Spitalit me kapacitet 300 - 350 L dhe temperature nen 5 grade C per ruajtjen e mbetjeve te rrezikshme spitalore anatomike te lengshme dhe te ngurta deri ne momentin e transportimit per ne impiantin e asgjesimit,**sipas pika 9.2.(tabela 2:Frekuencat e grumbullimit per grupe te ndryshme te mbetjeve spitalore) te** Udhëzuesit kombëtar “Administrimi i sigurt i mbetjeve Spitalore”

Pas marrjes se mbetjeve operatori do te beje dezenfektimin e frigoriferit dhe ambientit perreth , si dhe mirembajtjen e frigoriferit.

Referuar Kreut III për Trajtimin e mbetjeve Spitalore, pika 8.5/b të VENDIM Nr.798, datë 29.9.2010 PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR ADMINISTRIMIN E MBETJEVE SPITALORE", ku përcaktohet se: *“Të tregohet kujdes për sigurinë e kontejnerëve, të parandalohen rrjedhjet, të sigurohet mbrojtja nga uji, shiu dhe era, si dhe të shmangen kushtet e inkubimit mikrobik dhe/ose të dekompozimit të tyre. Mbetjet njerëzore, shtazore apo të ndonjë gjallese tjetër të magazinuara për më shumë se 24 orë, por gjithsesi më pak se 48 orë nga ambalazhimi, duhet të ruhen në frigorifer ose hapësirë frigoriferike që përdoret vetëm për mbetjet spitalore në një temperaturë jo më të lartë se 10°C”*

8.Tek formulari i transferimit te mbetjeve te rrezikshme spitalore te shenohen dhe kodet perkatese per cdo lloj mbetje :

- Anatomiket	KODI 18 01 02
- Te mprehtat	KODI 18 01 01
- Infektivet	KODI 18 01 03
- Të butat	KODI 18 01 04
- Citostatiket	KODI 18 01 08
- Farmaceutike	KODI 18 01 09

Specifikimet e enëve të ambalazhimit të mbetjeve spitalore

1. Kuti për të mprehtat

- Të jenë në përputhje me standardin Britanik BS 7320:1990 ose standartit SSH/EN,ekuivalent, ,mbi konformitetin e standartit european,dhe te leshuara nga organizma te vlersimit te konformitetit te akredituara ne Republiken e Shqiperise,në lidhje me rezistencën ndaj depërtimit dhe rezistencën ndaj rrjedhjes pas rënies vertikale dhe përmbysjes ose specifikime të ngjashme për konteinerët e të mprehtave;
- Hapja duhet të jetë aq e gjerë sa të lejojë materialet e asgjësueshme të hidhen në konteiner duke vepruar vetëm me një dorë. Në varësi nga masa e materialit të asgjësueshëm për të cilën është projektuar konteineri i posaçëm, hapja duhet, në kushte normale të përdorimit, të pengojë daljen/nxjerrjen e përmbajtjes;
- Nëse janë të pajisur me kapakë të lëvizshëm, ato duhet të jenë të projektuar në mënyrë të tillë që të mos jetë e nevojshme shtyrja me dorë e materialeve në konteiner;
- Të tillë që të mbyllen në mënyrë të sigurt dhe të mbeten të mbyllura gjatë transportit;
- Pasi janë mbyllur, të gjithë llojet e konteinerëve duhet të mos lejojnë rrjedhje;
- Kur është e mundur, të jenë të pajisura me dorezë që nuk është pjesë e pajisjes mbyllëse;
- Të ndezshme dhe të afta për t'u djegur në mënyrë të sigurt dhe nuk duhet të përbëhet nga polivinilkloridi (PVC); 11
- Kur është e mundur, të jetë e shënuar në mënyrë të dukshme me një vijë horizontale për të treguar kur kutia e të mprehtave është e mbushur ndërmjet 70% dhe 80% të vëllimit të saj maksimal, së bashku me fjalët "KUJDES - MOS E MBUSHNI MBI VIJË";
- Të tilla që në to të mund të shkruhet me bojë që nuk fshihet dhe të ngjitet në mënyrë të sigurt etiketa. Të etiketohen qartë me fjalët "RREZIK: TË MPREHTA TË NDOTURA" dhe duhet të përmbajnë simbolin e biohazardit në etiketë.

Koshat plastikë

- Të tillë që të mbyllen;
- Rezistent ndaj rrjedhjes, thyerjes nga goditja dhe korrozionit;
- Të tillë që në to të mund të shkruhet me bojë që nuk fshihet dhe të ngjitet në mënyrë të sigurt etiketa.

ETIKETIMI I ENËVE TË MBETJEVE SPITALORE

Çdo enë e mbetjeve spitalore duhet të ketë në pjesën e jashtme të saj një etiketë e cila duhet të përmbajë shenjën ndërkombëtare të Biohazardit sipas modelit me përmasat e specifikuara në Pjesën A dhe specifikimet në Pjesën B, si dhe përmbajtjen sipas Pjesës C të kësaj Shtojce. Etiketa duhet të prodhohet me material që u reziston rrezeve UV, ujit dhe të jetë ngjitesë, ose të jetë e para-printuar në një pozicion të dallueshëm të enës që lejon që të dhënat në etiketë të lexohen lehtë.

Tipi i enës së mbetjeve spitalore

Për të mprehtat

- me kapacitet prej më pak se 2 litra

- me kapacitet prej 2 litra ose më shumë

Përmasat e simbolit

jo më pak se 40 mm x 40 mm

jo më pak se 75 mm x 75 mm

- konteinerë të tjerë

jo më pak se 150 mm x 150 mm

Specifikimet e simbolit:

Ngjyrat e simbolit duhet të jenë si më poshtë:

Konturet – ngjyrë e zezë

Fusha – ngjyrë e bardhë ose ngjyra parësore e konteinerit

Fjalët dhe karakteret – ngjyrë e zezë



Shenja ndërkombëtare e Biohazardit – ngjyrë e zezë

Etiketa përfshin shenjën ndërkombëtare dalluese të rrezikut të mbetjes mjekësore, njoftimin e rrezikut mjekësor në shqip dhe në anglisht dhe numrin e parë të klasifikimit ndërkombëtar (6).

Madhësia minimale e etiketës duhet të jetë 14cm x 14cm dhe të ketë formën e një rombi.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen: “Evadim i mbetjeve të rrezikshme spitalore, per nevoja te SRV- Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)”.

Nr.	Emërtimi i mbetjeve	Kodi	Njësia	Shuma: Sasia e parashikuar per 12 muaj	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
1	Bisturite, shiringa, instrumente te mprehta (pervec 18 01 03)	18 01 01	kg	4864.3	SRV	Sipas DST.
2	Pjese te trupit dhe organe, perfshire qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut, sende te ndotura me gjak serume dhe palzme, mbetje nga paciente me koeficiente infektimi te larte.	18 01 02	kg	1386.6	SRV	Sipas DST.
3	Mbetjet, grumbullimi dhe asgjeksi I te cilave kerkon trajtimteve çante per te parandaluar infeksionet.	18 01 03	kg	17956.8	SRV	Sipas DST.
4	Mbetjet, grumbullimi dhe asgjeksi I te cilave nuk kerkon trajtim te veçante per te parandaluar infeksionet (psh.fasha ,gips,carcafe,veshje njeperdorimshme,pelena etj.)	18 01 04	kg	25	SRV	Sipas DST.
5	Medikamente, citostatike dhe citotoksike .	18 01 08	kg	14.7	SRV	Sipas DST.
6	Medikamente te tjera pervec atyre te permendura ne 18 01 08	18 01 09	Kg	20	SRV	Sipas DST

Afatet e ekzekutimit: Nga data e nenshkrimit të MK, deri ne nje vit (12 muaj).

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Evadim i mbetjeve të rrezikshme spitalore, për nevoja të SRV - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)''.

Detyrat: Operatori Ekonomik duhet të paraqitet sa herë merr njoftime nga Autoriteti Kontraktor, në bazë të nevojave të këtij të fundit.

Shpërndarja: do të realizohet në varësi të mbetjeve të prodhuara dhe të grumbulluara pranë Autoritetit Tonë Kontraktor, sipas muajve përgjatë 12 muajve dhe të ndara në tabelën më poshtë:

Nr.	Emërtimi i mbetjeve	Kodi	Njësia	Sasia e parashikuar për 12 muaj	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
1	Bisturite, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03)	18 01 01	kg	4864.3	SRV	Sipas DST.
2	Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qesë dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut, sende të ndotura me gjak serumë dhe palzme, mbetje nga pacienti me koeficiente infektimi të lartë.	18 01 02	kg	1386.6	SRV	Sipas DST.
3	Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi I të cilave kërkon trajtimet e çante për të parandaluar infeksionet.	18 01 03	kg	17956.8	SRV	Sipas DST.
4	Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi I të cilave nuk kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet (psh.fasha ,gips,carcafe,veshje njëpërdorimshme,pelena etj.)	18 01 04	kg	25	SRV	Sipas DST.
5	Medikamente, citostatike dhe citotoksike .	18 01 08	kg	14.7	SRV	Sipas DST.
6	Medikamente të tjera përveç atyre të përmendura në 18 01 08	18 01 09	Kg	20	SRV	Sipas DST

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve:

Spitali Rajonal Vlore

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kriterë duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Lista e cmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2;*
- c. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- d. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kriter 2.1.1. Operatori Ekonomik duhet të disponojë Leje mjedisore të tipit B (me kod III.1.B) ose Leje Mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) së bashku me Akt Miratimin përkatës si dhe liçencën profesionale përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore) që të përfshijnë mbetje të rrezikshme me kod 18 01 01; 18 01 03; 18 01 04, ku procedura e asgjësimit të jetë sterilizim me Autoklavim ose teknologji ekuivalente.

Kriteri 2.1.2. Operatori ekonomik duhet të disponojë Leje Mjedisore tipi A (me kod III.1.C), së bashku me Akt Miratimin përkatës si dhe liçencë Profesionale përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore), që të përfshijnë mbetjet me kod 18 01 02 dhe 18 01 08 18 01 09 ku procedura e asgjësimit të jetë me incenerim.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Pika 2.2.1: Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit/vlerës së pritshme të kontratave kësaj Proçedure Prokurimi.

Shënim*: Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera 40 % do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar/vlerës së pritshme të Kontratave për të cilën ofertohej.

Nëse operatorët ekonomikë, në këtë procedurë prokurimi, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këtë DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. **Pika 2.3.1:** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate/vlerës së pritshme të kontratave.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Shënim*: Për efekt të përllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera 20 % do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit/vlerën e prishtme të Kontratave për të cilën ofertohej.

2. **Kriteri 2.3.2:**

a.) Operatori duhet të ketë certifikatën **ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”**, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata kërkohej të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

b.) Operatori, duhet të ketë certifikatën **ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të ambjentit”** në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata kërkohej të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë Akt Miratimin Higjieno-Sanitar respektiv për objektet ku ushtron aktivitetin e sterilizimit dhe incenerimit të lëshuar nga ISHS (Inspektorati Shëndetësor Shtetëror).

2.3“Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë ne pronesi ose me qera minimalisht 1 (një) automjet i cili të përmbushë kriteret e percaktuara në Ligjin Nr. 8387 datë 22.07.1998 ” Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, **Nenin 47 Klasifikimi i mjeteve rrugore pika 2 - c kategoria N1 : ”Mjete të destinuara për transport mallrash dhe që kanë peshe maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 3.5 tone ” dhe sipas kërkesave të Nenit 23 të Ligjit Nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, si dhe Shtojcës 4 të VKM Nr.798, datë 29.9.2010, për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore” (Rregullorja) si dhe në zbatim të Pikës 9.3.3 (Automjetet/anijet e grumbullimit) të Udhëzuesit kombëtar ”Administrimi i sigurt i mbetjeve Spitalore”.**

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

- Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Për automjetin në pronësi: *Aktin e pronësisë së mjetit, leje qarkullimi, akt - kolaudimi dhe polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet së bashku me Akt -Miratimet Higjenosanitare, si dhe foto te mjeteve ku te duket qarte targa dhe sinjalistika perkatese.* Automjetet e perdorura duhet qe te plotesojne karakteristikave te mjetit te bazuara ne piken 8.8/c dhe shtojces 4, te VKM nr.798, date 29.09.2010 Per miratimin e rregullores, " Per administrimin e mbetjeve spitalore"si edhe pike 9.3.3 te Udhzuesit Kombetar "Administrimi i sigurt i mbetjeve Spitalore".

- Për automjetet që nuk janë në pronësi: *Kontratë qiraje të shoqëruar me aktin e pronësisë së qiradhënësit, ku afati i marrjes me qira të automjetit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit objekt prokurimi, si dhe leje qarkullimi, akt-kolaudim dhe polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet së bashku me Akt – Miratimet Higjenosanitare.*

- Automjetet e perdorura duhet qe te plotesojne karakteristikave te mjetit te bazuara ne piken **8.8/c dhe shtojces 4, te VKM nr.798, date 29.09.2010 Per miratimin e rregullores, "Administrimin e mbetjeve spitalore"**

SHTOJCA 4 KUSHTET QË DUHET TË RESPEKTOJË TRANSPORTIMI I MBETJEVE SPITALORE INFEKTUESE

Përveç automjeteve të urgjencës që kthehen nga vende aksidentesh, çdo automjet që transporton mbetje spitalore infektuese duhet të jetë lehtësisht i identifikueshëm gjatë transportimit të mbetjeve me shenjën dalluese ndërkombëtare të rrezikut të mbetjes mjekësore dhe fjalët e përshkruara në shtojcën 2. Automjetet e përdorura për transportin e mbetjeve spitalore infektuese:

- Duhet të përfshijnë një pjesë ngarkues-transportues, që rri e mbyllur dhe e siguruar përveçse kur ngarkon ose shkarkon mbetje spitalore për të parandaluar hyrjen dhe ekspozimin e paautorizuar ndaj erës dhe reshjeve.

- Duhet të jenë projektuar dhe ndërtuar në mënyrë të tillë që të mos lejojnë derdhjet; - Duhet të jenë pastruar dhe dizinfektuar pas rrjedhjeve ose derdhjeve aksidentale;

- Duhet të jenë pastruar dhe dizinfektuar para përdorimit për ndonjë qëllim tjetër; dhe

- Nuk duhen përdorur për të transportuar ushqime, produkte ushqimore, kontejnerë ushqimorë ose ndonjë substancë, e cila do të gëlltitet nga njerëzit ose kafshët ose do t'i shtohet ushqimeve të njerëzve ose kafshëve.

Gjatë transportimit të mbetjeve spitalore infektuese, automjetet duhet të mbajnë më vete një kit për ndalimin e derdhjeve dhe për pastrimin e automjetit. Çdo derdhje prej njëzet (20) ose më shumë kilogramësh, duhet të raportohet sa më shpejt që të jetë e mundur te punëdhënësi, Inspektorati Sanitar Shtetëror, Inspektorati Mjedisor, sikurse dhe tek organi kompetent i qeverisjes vendore. Çdo kontakt direkt i mjetit ose pajisjes me mbetjen spitalore duhet të konsiderohet dhe trajtohet si derdhje.

-
- *si edhe pike 9.3.3 te Udhzuesit Kombetar "Administrimi i sigurt i mbetjeve Spitalore".*

Automjetet e përdorur për transportin e mbetjeve spitalore duhet të kenë karakteristikat e mëposhtme:

- ☐ Të jenë të pajisur me pajisje mekanike për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e koshave/kontenierëve tranzit me manipulim dhe kontakt minimal të njeriut me koshat/kontenierët;
- ☐ Të aftë të sigurojnë mbajtjen e sigurt të koshave/kontenierëve tranzit gjatë udhëtimit dhe mirëmbajtjen e koshave/kontenierëve në një gjendje të mirë dhe sanitare;
- ☐ Përbëjnë ose një kamion plotësisht të mbyllur që ka një kabinë të ndarë, ose një automjet unitar në të cilën kabina e shoferit është e veçuar plotësisht nga ndarja ku vendosen mbetjet nga një paret i mbyllur i fiksuar;
- ☐ Ndarja për ngarkesën duhet të ketë ndriçimin dhe ajrimin e duhur, dyer që kyçen, të jetë kundër derdhjeve dhe të mund të pastrohet dhe dezinfektohet higjenikisht;
- ☐ Të pajisur me një kit veglash për riparime të vogla;
- ☐ Të pajisur me veshje të mjaftueshme të sigurisë, pajisje të dekontaminimit dhe pastrimit dhe materiale për trajtimin e derdhjeve (p.sh. veshjet mbrojtëse personale, qese plastike dhe kuti të mprehtash rezervë, dezinfektues, kokërriza absorbuese, furça, fshesa leckë, lopata dhe kova) (shih Shtojcën H);
- ☐ Të pajisur me pajisje të përshtatshme si telefon celular për të lehtësuar komunikimin me operatorin e impiantit të asgjësimit dhe Agjencinë Rajonale të Mjedisit.

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Pika 2.4.1: Operatori ekonomik duhet të paraqesë një kontratë të lidhur me një landfill të autorizuar/licensuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimi/ trajtimi (Mbetje nga iceneratoret ose piroliza e mbetjeve me kod 19 01 dhe mbetje të stabilizuara të ngurtësuar me kod 19 03), e cila duhet të jetë aktive dhe e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave.

Pika 2.4.2: Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qira impiantet për trajtimin me sterilizim dhe asgjësimin me incenerim të seciles kategori të prokuruar nga A.K të mbetjeve spitalore sipas Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, si dhe të VKM-se Nr. 798, datë 29.09.2010, për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore”, (Rregullorja), të licensuar nga Ministria e Mjedisit.

Për këtë Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

a. Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë ose të marrjes me qira të pajisjes (ku afati i marrjes me qira të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);

b. Lejen mjedisore të impiantit të lëshuar nga Ministria Mjedisit, ku parashikohet trajtimi i mbetjeve objekt prokurimi.

2.5 Operatori duhet të paraqesë mostra, për kontenitoret, sipas standarteve dhe kërkesave të VKM Nr. 798 datë 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore” pika 8/4 dhe 8/5 të kreut III, si më poshtë:

-
- Kontenitor plastike njëpërdorimësh për të mprehtat 18 01 01: përmasa që fillon nga 3L-12L
 - Kontenier plastike të ripërdorshëm të mëdhenj me qese plastmasi njëpërdorimësh për anatomiket 18 01 02 dhe infektivet 18 01 03, te cilet për çdo përdorim duhet të nenshtorhen pastrimit dhe larjes në makinerinë e posaçme të operatorit: përmasa që fillojnë nga 30 L deri në 60 L
 - Kontenitor kartoni njëpërdorimësh 18 01 04
 - Kontenitor të posaçëm të kuq përmasa deri në 20 L për citostatiket 18 01 08
 - Kuti të kyçura / të posaçëm për farmaceutiket 18 01 09

Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet pranë **Autoriteti Kontraktor**, të mbyllura me ngjitëse në zarf/a ose kuti jo transparente të vulosur/a, mbi të cilin/at të shënohet: “Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit « » dhe jo para datës 10.05.2023, ora 10 :00_.

